



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:199477
Datë: 26.11.2024
Numri i dokumentit: 06525238

A.nr.2285/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në konfliktin administrativ të paditësit L.M, nga fshati P..., Komuna Vushtrri, kundër të paditurit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, e cila përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, me bazë juridike anulim i vendimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencë të paditësit dhe mungesë të paditurit, në seancë publike, të datës 11.11.2024, mori, ndërsa me datën 26.11.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit L.M, nga fshati P..., Komuna Vushtrri, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi me numër 5249, i datës 01.04.2022 i të paditurit Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve si i paligjshëm si dhe të urdhërohet i padituri Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, që në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi të marrë vendim më të cilin do ta ndryshoj vendimin Nr.5249, i datës 01.04.2022 dhe të miratohet kërkesa e paditësit për njohën e të drejtës në pension të parakohshëm dhe kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës, SI E PABAZUAR.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi, me datën 28.09.2022, në këtë gjykatë ka paraqitur padi ndaj të paditurit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit. Tutje në padi ka kërkuar që gjykata pas administrimit të provave dhe përfundimit të seancës kryesore të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe të anulohet vendimin Nr. 5249, i datës 01.04.2022, i Ministrisë së Financave, Punë dhe

Transfereve-Departamente i Pensioneve në Prishtinë, si i kundërligjshëm dhe të urdhërohet i paditurit që në fatin prej 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi të marrë vendim me të cilin do të ndryshoj vendimin Nr.5249, të datës 01.04.022 dhe të miratohet kërkesën e paditësit për njohjen e të drejtës si përfitues i pensionit të parakohshëm nga dita e paraqitjes së kërkesës si dhe të ia kompenson në mënyrë retroaktive këtë pension nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë të gjitha të thënave në padi si dhe kërkesës së saj, sipas ligjit për të drejtat e ish punëtorëve të Trepçës i është refuzuar e drejta në pension të parakohshëm meqenëse është me probleme shëndetësore dhe atë jo të vogla por të mëdha, ka probleme me zemër, kolesterol dhe sheqer, tension dhimbje kurrizi dhe të gjurit, ka dëshminë për sëmundjen që e ka prej kardiologut, si dhe te fizioterapeuti shkon shpesh për shkak të problemeve që ka. Në fund ka shtuar se qëndron pranë të gjitha të lartcekurave si dhe padisë dhe kërkesës së saj.

I padituri, përmes përfaqësueses ligjore Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, në përgjigjen në padi të datës 01.02.2024 ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Ka theksuar se pala paditëse i pakënaqur ndaj vendimit të organi të shkallës së parë në afat ligjor ka paraqitur ankesën. Këshilli i Ankesës tek i padituri si organ i shkallës së dytë duke vepruar sipas ankesës të datës 25.08.2021 ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës pretendimet ankimore në përputhje me nenin 10 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Skemat Pensionale të financuar nga Shtetit, vlerësimin e komisionit mjekësor të datës 14.03.2022 dhe ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë përfitues si pensionit të parakohshëm. Tutje ka shtuar se duke pasur parasysh që vendimi i shkallës së dytë tek i padituri është me datën 01.04.2022, ndërsa padia është paraqitur në gjykatë me datën 28.09.2022, çka do të thotë së padia e paditësit është jashtë afatit ligjor. Ndër sa në fund ka shtuar se i propozon që gjykata të refuzoj si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurit.

Gjykata, në seancën gjyqësore të datës 11.11.2024, ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 41 të LKA-së, në mungesë të paditurit, i cili ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për seancë mirëpo nuk ka prezantuar, ndërsa mos ardhje e ka arsyetuar sipas parashtrësës së datës 08.11.2024, e cila është pranuar në zyrën e gjyqararit pas mbajtjes së seancës.

Vërtetimi i gjendjes faktike

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik, me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka administruar provat: Leximi i Vendimi i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, i datës 01.04.2022; Leximi i Vendimi me numër 15404 i lëshuar nga Kombinati Mineralo-Metalurgjik-Kimik i Plumbit dhe Zinkut Trepça; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Prishtinë, i datës 22.09.2022; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Prishtinë, i datës 21.09.2022; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Vushtrri, i datës 22.09.2022; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga SHPSHM Mitrovicë, i datës 23.09.2022; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Prishtinë, i

datës 21.09.2022, Dr. M.I; Leximi i Vërtetimi i lëshuar nga Trepça-Shoqëri Aksionare Departamenti Metalurgjia e Plumbit, e datës 04.09.2019; Leximi i Vërtetimi i lëshuar nga Trepça-Shoqëri Aksionare – Divizioni i Burimeve Njerëzore, i datës 23.09.2022; Leximi i Leje hyrja e lëshuar nga OP Metalurgjia e Plumbit për paditësin L.M; Leximi i Shkresa me numër të lëndës 5249 lidhur me të dhënat për pensionistin L.M e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Leximi i Raporti mjekësor nga Ordinanca specialistike internistike “Jeta”, e datës 25.08.2021; Leximi i Vendimi i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Pensioneve, i datës 18.08.2021; Leximi i Ankesa e paraqitur, me datën 25.08.2021 nga ankuesi L.M drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Administratës Pensionale; Leximi i Fletë regjistrimi pensionet e parakohshme – Trepça, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale Departamenti i Pensioneve i datës 01.09.2020; Leximi i Letërnjoftimi me të dhënat e paditësit L.M; Leximi i Vendimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, i datës 13.01.2021; Leximi i Flete dorëzimi i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve- Departamenti i Pensioneve – Qendra Rajonale e Pensioneve Mitrovicë; Leximi i Vendimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, i datës 01.09.2020; Leximi i Fletë regjistrimi pensionet e parakohshme – Trepça, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale Departamenti i Pensioneve, i datës 18.08.2021; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga Ambulanca në Mitrovicë, i datës 29.07.2021; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga Ambulanca në Mitrovicë, i datës 24.04.2014; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga Ambulanca në Mitrovicë, i datës 05.09.2019; Leximi i Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Vushtrri, e datës 27.07.2021 me numër NR.SER. E 25356710; Leximi i Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Vushtrri e datës 04.02.2020 me numër NR.SER.E24244235; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Prishtinë, i datës 28.07.2021; Leximi i Ankesa e paraqitur nga ankuesi L.M drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me datën 09.09.2020; Leximi i Vërtetimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve – Qendra Rajonale e Pensioneve në Mitrovicë, i datës 03.09.2019; Leximi i Formulari për aplikim për pension të parakohshëm të kompleksit Trepça, e datës 23.06.2020; Leximi i Formulari për aplikim për pension të parakohshëm të kompleksit Trepça, e datës 28.07.2021; Leximi i Vlerësimi i komisionit mjekësor – Divizioni i Komisioneve Mjekësore – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për L.M, i datës 24.03.2022. Leximi i Vlerësimi i komisionit mjekësor – Divizioni i Komisioneve Mjekësore – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për L.M, i datës 01.12.2022; Leximi i Dëftesa me numër 1673/19, e datës 09.2019; Leximi i Raporti mjekësor nga ordinanca specialistike U.C kardiologji-urologji, e datës 21.10.2024 – si dhe kuponi fiskal me numër 4; Shikohen: Ekage e zemrës për paditësin L...; Shikohen: Ehot, të datës 21.10.2024; Leximi i Raporti mjekësor fizioterapeutik i lëshuar nga terapia fizikale dhe rehabilitimi fizioterapia; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga Dr. A.B specialist i ortopedisë, i datës 30.10.2024; Leximi i Raporti mjekësor, i datës 29.10.2024 i lëshuar nga QKMF Pantinë; Leximi i Raporti mjekësor – recetë për barna i lëshuar nga QKMF Pantinë, e datës 25.03.2024; Leximi i Raporti mjekësor – analizat biokimike të lëshuar nga spitali Sh.Z Vushtrri, të datës 27.03.2024 së bashku me raportin e rezultateve të po të njëjtës datë; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga spitali Sh.Z Vushtrri, i datës 27.03.2024 në dy kopje; Leximi i Raporti mjekësor lëshuar nga QKMF Pantinë, i datës 25.03.2024; Leximi i

Raporti mjekësor lëshuar nga Dr. B.P specialist i kardiologjisë, i datës 27.03.2024; Leximi i Raporti mjekësor i Ekokardiografisë i lëshuar nga Dr. B.P, i datës 27.03.2024 të bashkangjitur dhe ekot; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga Dr. B.P, i datës 24.01.2023; Leximi i Raporti mjekësor i lëshuar nga Dr. H.R i datës 24.01.2023; Lexohen: Dëftesa e lëshuar nga institucioni Spitali Sh.Z dhe QKMF Dr. S.I, Vushtrri, të datës 24.01.2023.

Gjykata, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 44 të LKA-së, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar, për këto arsye:

Nga provat e administruara përkatësisht nga vendimi i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, i datës 01.04.2022, gjykata gjeti se palës paditëse, i padituri i ka refuzuar ankesa për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm, me arsyetimin se pala paditëse nuk ka dëshmi të mjaftueshëm për të qenë fitues i pensionit të parakohshëm.

Nga Vendimi me numër 15404 i lëshuar nga Kombinati Mineralo-Metalurgjik-Kimik i Plumbit dhe Zinkut Trepça, gjykata gjeti se paditësi ishte punësuar në kombinat Mineralo-Metalurgjik-Kimik i Plumbit dhe Zinkut Trepça, me datën 30.06.1989, në pozitën si Agjustator për mirëmbajtjen e konturit TF dhe kompresorëve.

Nga raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Prishtinë, i datës 22.09.2022, raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Prishtinë, i datës 21.09.2022, raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Vushtrri, i datës 22.09.2022, raporti mjekësor i lëshuar nga SHPSHM Mitrovicë, i datës 23.09.2022, raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Prishtinë, i datës 21.09.2022, Dr. M.I, Leximi i Raporti mjekësor nga Ordinanca specialistike internistike “J...”, e datës 25.08.2021, raporti mjekësor i lëshuar nga Ambulanca në Mitrovicë, i datës 29.07.2021, raporti mjekësor i lëshuar nga Ambulanca në Mitrovicë, i datës 24.04.2014, raporti mjekësor i lëshuar nga Ambulanca në Mitrovicë, i datës 05.09.2019, raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Prishtinë, i datës 28.07.2021, raporti mjekësor nga ordinanca specialistike U.C kardiologji-urologji, e datës 21.10.2024 – si dhe kuponi fiskal me numër 4, Ekage e zemrës për paditësin L..., Echot, të datës 21.10.2024, raporti mjekësor fizioterapeutik i lëshuar nga terapia fizikale dhe rehabilitimi fizioterapia, raporti mjekësor i lëshuar nga Dr. A.B specialist i ortopedisë, i datës 30.10.2024, raporti mjekësor, i datës 29.10.2024 i lëshuar nga QKMF Pantinë, raporti mjekësor – recetë për barna i lëshuar nga QKMF Pantinë, e datës 25.03.2024, raporti mjekësor – analizat biokimike të lëshuar nga spitali Sh.Z Vushtrri, të datës 27.03.2024 së bashku me raportin e rezultateve të po të njëjtës datë, raporti mjekësor i lëshuar nga spitali Sh.Z Vushtrri, i datës 27.03.2024 në dy kopje, raporti mjekësor lëshuar nga QKMF Pantinë, i datës 25.03.2024, raporti mjekësor lëshuar nga Dr. B.P specialist i kardiologjisë, i datës 27.03.2024, raporti mjekësor i Ekokardiografisë i lëshuar nga Dr. B.P, i datës 27.03.2024 të bashkangjitur dhe ekot, raporti mjekësor i lëshuar nga Dr. B.P, i datës 24.01.2023, raporti mjekësor i lëshuar nga Dr. H.R i datës 24.01.2023, dëftesa e lëshuar nga institucioni Spitali Sh.Z dhe QKMF Dr. S.I, Vushtrri, të datës 24.01.2023, gjykata gjeti se pala paditëse vuan nga sëmundje të ndryshme për të cilat ka pranuar tretman mjekësor.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Trepça-Shoqëri Aksionare Departamenti Metalurgjia e Plumbit, e datës 04.09.2019, gjykata gjeti se paditësi ka qenë i punësuar në Kompleksin Trepça SH.A, prej datës 01.08.1986 deri në 31.10.1990, ndërsa nga data 01.01.1991 i është pamundësuar vazhdimi i marrëdhënies së punës deri me datën 30.06.1999, ndërsa prej datës 01.07.1999 deri me 31.12.2004 ka qenë i pamundur angazhimi në punë dhe përfundimisht ka humbur vendin e punës. Tutje në vendim është bërë rekapitulimi i viteve të punës duke cekur se nga periudha 01.08.1989 deri me 31.10.1990 janë tri vite, nga periudha prej 01.01.1991 deri me 30.06.1999 janë 8.6 vite dhe periudha prej 01.07.1999 deri me 31.12.2004 janë 5.6 vite, gjithsej 17 vite punë.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Trepça-Shoqëri Aksionare – Divizioni i Burimeve Njerëzore, i datës 23.09.2022, gjykata gjeti se pala paditëse ka qenë punëtorë në njësinë biznesore Metalurgjia e Plumbit Trepça SH.A nga vitit 01.08.1989 deri në dëbimin me dhunë nga puna me datën 31.10.1990.

Nga leje hyrja e lëshuar nga OP Metalurgjia e Plumbit për paditësin L.M, gjykata gjeti se paditësi përmes kësaj leje ka pasur qasje brenda rrethojës dhe objektit OP Metalurgjia e Plumbit Trepça.

Nga shkresa me numër të lëndës 5249 lidhur me të dhënat për pensionistin L.M e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Vendimi i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Pensioneve, i datës 18.08.2021, gjykata gjeti se pala paditëse ka paraqitur kërkesë për pension e parakohshëm, përkatësisht sipas vendimit të lëshuar nga Ministria e lartcekur, i datës 18.08.2021, i padituri kishte refuzuar kërkesën e palës paditëse për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm, me arsyetimin se i njëjti nuk i përmbush të gjitha kriteret e parapara me ligj.

Nga ankesa e paraqitur, me datën 25.08.2021 nga ankuesi L.M drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Administratës Pensionale, gjykata gjeti se pala paditëse ka ushtuar ankesë ndaj vendimit të paditurit të datës 18.08.2021.

Nga fletë regjistrimi pensionet e parakohshme – Trepça, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve i datës 01.09.2020 dhe letërnjoftimi me të dhënat e paditësit L.M, gjykata gjeti se paditësit është regjistruar si kërkues për pension të parakohshëm.

Nga vendimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, i datës 13.01.2021, gjykata gjeti se Ministria e lartcekur ka refuzuar ankesën e palës paditëse për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm, të cilin vendim paditësi sipas fletë dorëzimit i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve- Departamenti i Pensioneve - Qendra Rajonale e Pensioneve Mitrovicë, ka pranuar me datën 25.08.2021.

Nga vendimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, i datës 01.09.2020, gjykata gjeti se paditësit nga Ministria e lartcekur, i është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm.

Nga fletë regjistrimi pensionet e parakohshme – Trepça, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale Departamenti i Pensioneve, i datës 18.08.2021, gjykata gjeti se gjykata gjeti se paditësit është regjistruar si kërkues për pension të parakohshëm.

Nga ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Vushttri, e datës 27.07.2021 me numër NR.SER. E 25356710 dhe Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Vushttri e datës 04.02.2020 me numër NR.SER.E24244235, gjykata gjeti se paditësi ka vendbanim në fshatin Pantinë, Komuna Vushttri.

Nga ankesa e paraqitur nga ankuesi Lulzim Murati drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me datën 09.09.2020, gjykata gjeti se paditësi kishte ushtuar ankesë ndaj vendimit Nr.45249, të datës 01.09.2020.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve – Qendra Rajonale e Pensioneve në Mitrovicë, i datës 03.09.2019, gjykata gjeti se paditësi ka përvojë punë gjatë vitit 1989 ka 5 muaj e 14 ditë, për vitin 1987 ka 12 muaj, për vitin 1988 ka 5 muaj e 15 ditë për vitin 1989 ka 6 muaj e 1 ditë dhe për vitin 1990 ka 8 muaj e 11 ditë, përkatësisht stazhi pension 18.07.1986 – 14.06.1988 dhe 30.06.1989- 11.09.1990.

Nga formulari për aplikim për pension të parakohshëm të kompleksit Trepça, e datës 23.06.2020 dhe formulari për aplikim për pension të parakohshëm të kompleksit Trepça, e datës 28.07.2021, gjykata gjeti se pala paditëse ka paraqitur kërkesa për pension të parakohshëm.

Nga vlerësimi i komisionit mjekësor – Divizioni i Komisioneve Mjekësore – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për L.M, i datës 24.03.2022 dhe vlerësimi i komisionit mjekësor – Divizioni i Komisioneve Mjekësore – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për L.M, i datës 01.12.2022, gjykata gjeti se komisioni në bazë anamnezës, analizave, raporteve specialistike, ekzaminimit objektiv dhe dokumentacionit tjetër kanë ardhur në përfundim se kërkesa e palës paditëse duhet të refuzohet, përkatësisht edhe pas rivlerësimit sipas ankesës së paditësit, e njëjta ka ardhur në përfundim se duhet të refuzohet.

Nga dëftesa me numër 1673/19, e datës 09.2019, gjykata gjeti se paditësit kishte paraqitur kërkesën për njohën e të drejtës në pension të parakohshëm.

Baza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës

Në nenin 10 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti parashihet se “1. Të drejtën për pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë të punësuarit në kompleksin

“Trepça” dhe në minierat e tjera të Kosovës, të cilët kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004. 2. Pensionet e parakohshme do t’iu paguhen të gjithë minatorëve të kompleksit “Trepça” dhe minatorëve të tjerë të punësuar në minierat e Kosovës, dhe të punësuarve tjerë në miniera nëse: 2.1. janë shtetas të Republikës së Kosovës; 2.2. posedojnë dokumentet e identifikimit nga organi përkatës i Republikës së Kosovës; 2.3. nëse kanë moshën prej pesëdhjetë (50) – gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç; 2.4. kanë së paku dhjetë (10) vite stazh pune në miniera; 2.5. nuk janë në marrëdhënie pune apo të vetëpunësuar; 2.6. nëse dëshmojnë se iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, pa fajin e tyre; 2.7. janë të paaftë për punë, për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tyre shëndetësore, me kusht që shkalla e invaliditetit të jetë mbi pesëdhjetë për qind (50%); 3. Aftësia e kufizuar prej pesëdhjetë për qind (50 %) që kërkohet në nënparagrafin 2.7 të paragrafit 2. të këtij neni, vlerësohet nga Komisioni Mjekësor i Ministrisë. 4. Pensionet e parakohshme do të ndërpriten së paguari, nëse personi: 4.1. mbush moshën e pensionimit për realizimin e pensionit bazik të moshës; 4.2. punësohet apo vetëpunësohet; 4.3. ka përmirësime të gjendjes shëndetësore mbi pesëdhjetë për qind (50 %) ose; 4.4. vdes”. Në nenin 5 të UA nr.07/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Ankimit në Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti par.1 dhe 2 është përcaktuar se “1. Të drejtën në pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë të punësuarit në Kompleksin “Trepça” dhe në minierat e tjera të Kosovës, të cilët e kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004, shtetas të Kosovës të moshës prej pesëdhjetë (50) deri në gjashtëdhjetë e pesë (65). 2. Dokumentet që duhen parashtruar janë: 2.1 Letërnjoftimi i lëshuar nga organi përgjegjës i Republikës së Kosovës, 2.2 Dëshmi për së paku dhjetë (10) vjet stazh pune në minierat e Kompleksit “Trepça” dhe minierave tjera, 2.3 Dëshmi se nuk janë në marrëdhënie pune apo të vetëpunësuar, 2.4 Dëshmi se iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, pa fajin e tij/saj; 2.5 Dëshmi se janë të pa aftë për punë përmbi 50%, për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, 2.6 Ekstrakt nga Zyra Civile se është banor i përhershëm në adresën e caktuar, 2.7 Ekstraktin e lindjes, 2.8 Një nga dëshmitë për faturat të cilat janë në emër të tij, faturën e tatimit në pronë, energjisë elektrike, ujit apo mbeturinave, 2.9 Dëshmi të tjera eventuale, të kërkuara nga zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse”.

Mbi bazën e gjendjes së mësipërme faktike dhe dispozitat ligjore të cituara, gjykata vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i të paditurit është i ligjshëm dhe i drejtë, pasi që vendimi i kontestuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, në lidhje me formën dhe elementet e detyrueshme të cilat duhet ti ketë akti administrativ dhe rregullat e procedurës, të cilat duhet të ndiqen për trajtimin e kërkesës për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm, e për të cilat shkaqe gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 44 par.2 të LKA-së. Vendimi i kontestuar i të paditurit është i qartë dhe i kuptueshëm. I njëjti përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar të paraparë me nenin 47 dhe 48 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi përmban hyrjen, pjesën urdhëruese-dispozitivin si dhe arsyetimin e vendimit. Në arsyetim janë paraqitur arsye të mjaftueshme për refuzimin e ankesës së paditëses, të cilat edhe gjykata i pranon, duke vlerësuar se edhe drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata, nga shkresat e lëndës konstaton se i padituri në procedurën administrative ka konstatuar se paditësi nuk ka dëshmi të mjaftueshëm për të qenë përfitues i pensionit të parakohshëm, andaj nuk plotësohet kushti ligjor i paraparë me nenin 10 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti. Në këtë drejtim gjykata thekson se paditësi në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, por edhe në procedurë administrative të zhvilluar tek i padituri, nuk rezulton ti ketë përmbushur kushtet ligjore nga neni 10 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, neni 5 par.1 dhe 2 i UA nr.07/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Ankimit në Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, për ta fituar dhe realizuar të drejtën në pension të parakohshëm. Paditësi nga provat shkresore të bashkangjitura nuk e ka dëshmuar përvojën e punës/stazhin në miniera prej 10 vite, siç kërkohet me dispozitat ligjore të lartcekura, respektivisht i njëjti në bazë të dëshmive të paraqitura përkatësisht nga vërtetimi i lëshuar nga Trepça-Shoqëri Aksionare Departamenti Metalurgjia e Plumbit, e datës 04.09.2019 dhe vërtetimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve – Qendra Rajonale e Pensioneve në Mitrovicë, i datës 03.09.2019, gjykata gjeti se paditësi ka përvojë punë gjatë vitit 1989 ka 5 muaj e 14 ditë, për vitin 1987 ka 12 muaj, për vitin 1988 ka 5 muaj e 15 ditë për vitin 1989 ka 6 muaj e 1 ditë dhe për vitin 1990 ka 8 muaj e 11 ditë, përkatësisht stazhi pension 18.07.1986 – 14.06.1988 dhe 30.06.1989- 11.09.1990, respektivisht nga e cila rezulton se i njëjti ka gjithsej 3 vite e 1 muaj e 11 ditë stazh punë në Kombinati Mineralo-Metalurgjik-Kimik i Plumbit dhe Zinkut Trepça, ndërsa për periudhën nga data 01.01.1991 e deri me datën 30.06.1999, paditësit nuk i është vazhduar marrëdhënia e punës, ndërsa nga data 01.07.1999 e deri me datën 31.12.2004, paditësi ka humbur vendin e punës. Po ashtu paditësi me dokumentacionin relevant nuk ka dëshmuar se i njëjti nuk është në marrëdhënie punë, e po ashtu siç nuk ka dëshmuar se është i pa aftë për punë, për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tij shëndetësore, me kusht që shkalla e invaliditetit të jetë mbi pesëdhjetë për qind (50%), ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Duke pasur parasysh të mësipërmen, del se palës për të ju njohur e drejta në pension të parakohshëm duhet të plotësoj komulativisht të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara si më lartë, andaj kjo gjykatë vlerësoi se paditësi në rastin konkret nuk ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të paraparë si në dispozitën e lartcekur dhe se në këtë çështje administrative janë respektuar rregullat e procedurës administrative të cilat kanë pasur ndikim në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj, sepse i vlerësoj pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura në procedurë administrative.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata përfundimisht konstaton se vendimi i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, i datës 01.04.2022, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata, përkundër faktit se për afatshmërinë e padisë kujdeset zyrtarisht, e njëjta vlerësoi edhe pretendimin e palës së paditur lidhur me afatshmërinë e padisë së paditësit, mirëpo e njëjta gjeti se një pretendim i tillë është i papabazuar, për faktin se pala e paditur nuk ka bashkangjitur asnjë

prove me të cilën do të argumentonte se paditësi ka paraqitur padinë jashtë afatit ligjor, ndërsa nga shkresat e lëndës përkatësisht nga provat e bashkangjitura nga pala paditëse, del se pala paditëse, vendimin e të paditurit, të datës 01.04.2022 e ka pranuar me datën 05.09.2022 e cila mban dhe nënshkrimin, andaj, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 63 të LKA-së e në lidhshmëri me nenin 7 par. 1 të LPK-së i cili parasheh se: *“7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, e njëjta vlerësoi se padia e paditësit është e afatshme.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë të i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 38 par.1 dhe 2 dhe nenit 46 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2285/22, me datë 11.11.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.